



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU - PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rr. Ilir Konushevi, Nr.8, 10000 Prishtinë
info@pak-ks.org – www.pak-ks.org

E Marte, 14 Dhjetor 2010

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Ndërmarrja e Re Tregu i Bylmetit SH.P.K. tërhiqet nga Vala 47 e privatizimit

PRISHTINË – Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) ka tërheqë sot nga Vala e 47-të e Privatizimit, Ndërmarrjen e Re Tregu i Bylmetit SH.P.K. Kjo ndërmarrje ishte paraparë të privatizohet me datë 15 Dhjetor përmes Valës 47.

Më poshtë mund të gjeni listën me 18 Ndërmarrje të Reja që do të jenë në dispozicion në Valën 47:

Ndërmarrja e Re Tokë Bujqësore Zidi i Sadik Agës A SH.P.K. (Ri tenderim) gjendet në pjesën kryesore të Komunës së Gjakovës, përgjatë rrugës rajonale Gjakovë Prizren. Kjo Ndër. e Re përbëhet kryesisht nga toka bujqësore. Ndër. e Re do të përbëhet prej përafërsisht 390712 m² (39 ha 07 ari dhe 12 m²). Ky tender i ofron investitorit potencial mundësinë e zhvillimit të mëtejme të agrobiznesit në rajonin e Gjakovës.

Ndërmarrja e Re Tokë Bujqësore Zidi i Sadik Agës B SH.P.K. (Ri tenderim) gjendet në pjesën kryesore të Komunës së Gjakovës, përgjatë rrugës rajonale Gjakovë Prizren. Kjo Ndër. e Re përbëhet kryesisht nga toka bujqësore. Ndër. e Re do të përbëhet prej përafërsisht 508248 m² (50 ha 82 ari dhe 48 m²). Ky tender i ofron investitorit potencial mundësinë e zhvillimit të mëtejme të agrobiznesit në rajonin e Gjakovës.

Ndërmarrja e Re Tokë Bujqësore Zidi i Sadik Agës C SH.P.K. (Ri tenderim) gjendet në pjesën kryesore të Komunës së Gjakovës, përgjatë rrugës rajonale Gjakovë Prizren. Kjo Ndër. e Re përbëhet kryesisht nga toka bujqësore. Ndër. e Re do të përbëhet prej përafërsisht 418696 m² (41 ha 86 ari dhe 96 m²). Ky tender i ofron investitorit potencial mundësinë e zhvillimit të mëtejme të agrobiznesit në rajonin e Gjakovës.

Ndërmarrja e Re Tokë Bujqësore Dubrava/Arllat SH.P.K. me rreth 147 ha 16 ar 94 m² tokë bujqësore. Ndër. E Re shtrihet në zonën kadastrale Arllat gjendet larg udhëkryqit të Komoranit afro 11km kurse, larg kryeqendrës Prishtina gjendet larg afro 34km dhe pronat e kesaj shtrihen buzë rrugës rajonale Prishtinë-Malishevë prej afro 1200 metra.

Për më shumë informata ju lutemi kontaktoni Znj. Arta Gosalci në arta.gosalci@pak-ks.org
apo në 038 500 400 lokali 1110

Ndërmarrja e Re Tokë Bujqësore Kodra e Hutit SH.P.K. me rreth 150,40.42 ha (150 ha 40 ari 42m²) tokë bujqësore shtrihet në zonën kadastrale Kodra e Hutit e cila është rreth 5 km larg qendrës së qytetit të Gjakovës dhe rreth 1 km në perendim larg magjistralës Gjakovë-Deqan.

Në këtë tender nuk është përfshirë asnjë bagëti apo asete tjera të lëvizshme.

Ky tender i ofron investitorit potencial mundësinë e zhvillimit të mëtejshëm të agrobiznesit në rajonin e Gjakovës.

Ndërmarrja e Re Tokë Bujqësore Rracaj SH.P.K. me rreth 108,39.17 ha (108 ha 39 ari 17m²) tokë bujqësore shtrihet në një kompleks në katër zona kadastrale Rracaj, Kodra e hutit, Skivijan dhe Osek hylë.

Ky kompleks shtrihet në anën e majtë të rrugës nacionale Gjakovë-Pejë , në Veri-Perëndim të Gjakovës me një largësi në vijë ajrore prej afro 6 km. Këtë kompleks bujqësor e prekin rrugë publike, njëra prej të cilave i shkon përmes kompleksit e njëherit është kufi mes Zonave Kadastrale, Skivijan-Rracaj.

Në këtë tender nuk janë të përfshira bagëti apo asete tjera të lëvizshme.

Ky tender i ofron investitorit potencial mundësinë e zhvillimit të mëtejshëm të agrobiznesit në rajonin e Gjakovës.

Ndërmarrja e Re Stacionit te Veterinarisë SH.P.K. ne Mitrovicë SH.P.K. gjendet ne Komunën e Mitrovicës dhe përbëhet nga prona e përshkruar sipas parcelës 2908-2 dhe certifikatës poseduese nr 6341 dhe ka sipërfaqe të përgjithshme prej 2419 m². Ne kuadër te kësaj hapësire te përgjithshme ndodhet edhe ndërtesa me rreth 200 m².

Ndërmarrja e Re Mihaliq SH.P.K. përbehet prej tokës bujqësore-kodrinore, me lokacion në fshatin Mihaliq, komuna e Vushtrrisë, përafërsisht përfshinë 43.85.81 hektarë tokë.

Ndërmarrja e Re Shitorja në Gojbulë dhe ngastra komerciale në Gracë SH.P.K.

përbehet nga një shitore dhe tokë në Fshatin Gojbulë dhe një ngastër komerciale në Fshatin Gracë Komuna e Vushtrrisë.

1. Shitorja (me ish emrin Avalla 3219) qe pritet te bartet te Ndër. e Re gjendet në qendër të Fshatit Gojbulë përball shkollës fillore të fshatit; Komuna e Vushtrrisë dhe përfshin ndërtesën dhe tokën me sipërfaqe përreth 199 m² .

2. Ngastra komerciale (me ish emrin "29 Nëntori" 1348/74) që pritet të bartet te Ndër. e Re gjendet në qendër të fshatit Gracë dhe përfshin një sipërfaqe përreth 1748 m².

Ndërmarrja e Re Shtëpia e Mallrave Univerzal SH.P.K përfshinë pronën në parcelën nr.2938 lista poseduese nr 357 e cila gjendet në rrugën 24 Nëntori-Leposaviq, me sipërfaqe te përgjithshme prej 2892m². Me këtë hapësire është lokalizuar objekti i Shtëpisë së Mallrave me sipërfaqe prej 1208m².

Lokalet gjenden në rrugën 24 Nëntori në Leposaviq.

Ndërmarrja e Re Depoja Univerzal SH.P.K. përfshinë pronën në parcelën nr 2544, lista poseduese nr 357 e cila gjendet ne Slanishtë-Leposaviq, me sipërfaqe te përgjithshme prej 7497m².Me këtë hapësire është lokalizuar objekti i deposë me sipërfaqe prej 2655m².

Lokalet gjenden në Slanishtë, Komuna e Leposaviqit.

Ndërmarrja e Re Çyçavica Shitorja Metrazha SH.P.K. përbehet nga një shitore me sipërfaqe të përafërt prej 74.38 m², në rrugën Dëshmorët e Kombit në Vushtrrisë.

Ndërmarrja e Re NHTT Rugova Depoja e Pijeve SH.P.K. përfshin objektin prej 141m², që gjendet në një lokacion shumë atraktiv për tregti, në qendër të qytetit, në rrugën kryesore mjaft të frekuentuar.

Ndërmarrja e Re Deva Uzina e Përpunimit të Gazrave SH.P.K. ofron objektet e uzinës për përpunimin e gazrave teknike me asetet kryesore, si kompleksi funksional për përpunimin e gazrave teknike i përbërë prej 5 objekteve kryesore me makineri, stacioneve punuese, anekseve dhe pajisjeve tjera me sipërfaqe të përgjithshme rreth 3860m² që ndodhen në zonën industriale me sipërfaqe totale prej rreth 08.21.00 ha në Gjakovë.

Ndërmarrja e Re Rilindja Shitja Pejë SH.P.K. i ofron blerësve potencial mundësi për blerjen e lokalit afarist me një sipërfaqe prej përafërsisht 153 m² që gjendet në pjesën shumë atraktive të Pejës.

Ndërmarrja e Re Rilindja Shitja Mitrovicë SH.P.K. i ofron blerësve potencial mundësi për blerjen e lokalit afarist me një sipërfaqe prej përafërsisht 79,09 m² që gjendet në pjesë n shumë atraktive të Mitrovicës.

Ndërmarrja e Re Rilindja Libraria Gllgovc SH.P.K. i ofron investitorit potencial një mundësi të fitoj lokalit afarist me sipërfaqe përafërsisht 75 m², e cila gjendet në qendër të Gllgovcit, që ofron mundësi të mira për aktivitete komerciale.

Ndërmarrja e Re Flora Tokë Bujqësore II SH.P.K. ofron tokë bujqësore me sipërfaqe përafërsisht 10,07,21 m² (10 ha 7 ari 21 m²) në një pjesë atraktive të Podujevës, në fshatrat Zakut dhe Pakashticë e Poshtme. Prodhimtaria e produkteve bujqësore mund të rritet dukshëm me investime përkatëse.

FUND